

Vendim nr 182 datë 10.07.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 10.07.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 11 (E) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ENVER SHPATA, përfaqësuar nga avokat Xhemal Gazidede, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.
Shfuqizimi i vendimeve nr. 73 (86-2018-75), datë 19.01.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2025-276, datë 30.01.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Lënia në fuqi e vendimit nr. 1334, datë 16.03.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 41 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka qenë punonjës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (*DPD*) nga muaji dhjetor 2006 në detyra të ndryshme në Njësinë e Antikontrabandës Tokësore, shef grupi në Drejtorinë e Antikontrabandës në kategorinë “C1” pranë Departamentit Operativ Hetimor, inspektor në Sektorin e Antikontrabandës Tokësore, në Drejtorinë e Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit. Në datën 24.12.2013 atij i është komunikuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës. Me pretendimin se gjatë periudhës së punës ai ka përfituar vetëm pagën dhe dietat, por nuk është paguar për punën e kryer përgjatë ditëve të pushimit javor, festave zyrtare dhe orët e punës jashtë orarit zyrtar, kërkuesi i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, me objekt detyrimin e palës së paditur, DPD-së, t’i paguajë ditët e pushimit javor, festave zyrtare të punuara dhe të papaguara plus shtesat 50 %, si dhe shtesat mbi pagën për punën jashtë orarit për tre vitet e fundit nga data 24.12.2010 deri 24.12.2013, në shumën 2.500.000 lekë.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.1334, datë 16.03.2015, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke detyruar palën e paditur t’i paguajë kërkuesit ditët e punës të kryera dhe të papaguara përgjatë ditëve të pushimit javor, festave zyrtare (plus shtesat 50 %), si dhe shtesat mbi pagën për punën jashtë orarit për periudhën 24.12.2010 deri 24.12.2013 në shumën gjithsej 2.337.030 lekë. Përderisa shuma e përlllogaritur nga eksperti ka rezultuar më e vogël sesa ajo e përcaktuar nga kërkuesi në objektin e saktësuar të kërkesëpadisë, gjykata ka vendosur rrëzimin e pjesës tjetër të kërimit përtej vlerës së përcaktuar në këtë vendim si të pabazuar në ligj dhe në prova. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala e paditur, DPD-ja.

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 73 (86-2018-75), datë 19.01.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin tërësisht të padisë së kërkuesit me arsyetimin se ai nuk ka të drejtën e kompensimit financiar për orët e punës shtesë tej orarit normal të punës, pasi veprimtaria që ai ka kryer në detyrën e ngarkuar nuk rezulton të klasifikohet si veprimtari operationale dhe pretendimet e tij janë të pabazuara në ligj e në prova.

4. Për rekursin e kërkuarit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-276, datë 30.01.2025, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikon neni 58 i ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, të ndryshuar (ligji nr. 49/2012).

5. Në datën 24.04.2025 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar më 05.05.2025.

II

Pretendimet e kërkuarit

6. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar:

6.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

6.1.1. *Së drejtës për t’u dëgjuar*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duhet të kishte vendosur shqyrtimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Referuar përmbajtjes së nenit 62, shkronjat “b” dhe “c”, të ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar me ligjin nr. 39/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (ligji nr. 39/2017) Gjykata e Lartë mund të disponojë në dhomën e këshillimit vetëm mospranimin e rekursit ose kalimin e çështjes në seancë gjyqësore.

6.1.2. *Së drejtës për një gjykim të drejtë e të paanshëm*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka arsyetuar se përse kërkuari nuk ka paraqitur shkaqe në recurs që lidhen me zbatimin e gabuar të ligjit material, ndonëse këto shkaqe lidhen me interpretimin e gabuar të Kodit të Punës, Kodit Doganor dhe disa VKM-ve për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore. Kërkuari është paguar vetëm për orarin zyrtar, ndonëse ekspertimi ka përcaktuar se ai ka kryer punë 174 orë në muaj edhe në ditët e pushimit javor, festave zyrtare dhe orëve jashtë

orarit. Në kushtet kur kërkuesi nuk është më në marrëdhënie pune ai nuk ka mundësi të kompensohet për këto orë pune, të cilat janë provuar sipas provave të administruara në gjykim. Gjykata e apelit në mënyrë të gabuar ka përcaktuar se kërkuesi është trajtuar me dietë, arsyetim i cili është në kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi për punonjësit doganorë nuk përfshihen shpenzimet e transportit, por vetëm ato për fjetje dhe ushqim. Për më tepër, natyra e punës së punonjësve të Antikontrabandës është e vështirë dhe ligji ka parashikuar që ata përfitojnë pagesë për punën në ditët e pushimit javor dhe festat zyrtare. Pala e paditur nuk ka provuar në gjykim se ka miratuar turne shtesë për të kompensuar me pushim këto orë pune. Ligji nuk ka përcaktuar se për shkak të vështirësisë së punës punëmarrësi duhet të punojë jashtë orarit dhe në ditët e pushimit javor e festat zyrtare.

- 6.2. *Parimit të barazisë përpara ligjit*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrim të ndryshëm në një vendim me të njëjtin objekt, në të cilin ai ka pranuar kompensimin e palës paditëse për orët e punës shtesë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë njëkohësisht kriteret kumulative të parashikuara në nenin 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në

procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e paraqitur, për rrjedhojë është bartës i të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara.

9. Në lidhje me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

10. Kolegji çmon se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 30.01.2025, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 24.04.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

11. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t’u dëgjuar dhe së drejtës për një gjykim të drejtë e të paanshëm, si dhe parimit të barazisë përpara ligjit.

12. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar, Kolegji vëren se kërkuesi ka argumentuar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duhet të kishte vendosur shqyrtimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Sipas kërkuetit, referuar përmbajtjes së nenit 62, shkronjat “b” dhe “c”, të ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar me ligjin nr. 39/2017, Gjykata e Lartë mund të disponojë në dhomën e këshillimit vetëm mospranimin e rekursit ose kalimin e çështjes në seancë gjyqësore.

13. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pranuar si elemente përbërëse të procesit të rregullt ligjor edhe të drejtën për t’u dëgjuar. Kjo e drejtë, në unitet edhe me të drejta të tjera, ka për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që, përpara marrjes së vendimit gjyqësor, të dëgjohet realisht për thelbin e çështjes. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t’u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklaratimet e tyre, për parashkrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore (*shih vendimet nr. 7, datë 12.03.2010; nr.12, datë 06.06.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Referuar dokumenteve bashkëlidhur kërkesës, Kolegji konstaton se çështja e kërkuetit është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 02.02.2018, mbi bazën e rekursit të tij. Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikon neni 58 i ligjit nr. 49/2012. Kolegji vëren se sipas nenit 61, pika 1, të ligjit nr. 49/2012 shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomën e

këshillimit, kurse në nenet 62 dhe 62/a të këtij ligji janë parashikuar edhe rastet kur shqyrtimi i çështjes bëhet në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Këto dispozita janë ndryshuar me ligjin nr. 49/2021, i cili ka hyrë në fuqi në datën 29.05.2021, në dispozitën kalimtare të të cilit, ndër të tjera, është parashikuar se procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji. Për sa i përket zbatimit të ligjit procedural, Gjykata është shprehur se përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe, ai zbatohet menjëherë në përputhje me parimin *tempus regit processum*. Në të drejtën procedurale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe (*shih vendimet nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 3, datë 11.02.2021; nr. 11, datë 23.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Kolegji konstaton se Gjykata e Lartë, pasi ka shqyrtuar rekursin e kërkuarit, ka vlerësuar se nuk përmban asnjë nga shkaqet për të cilat mund të ushtrohet e drejta e rekursit, duke vepruar në përputhje me kompetencat e saj dhe me parashikimet ligjore që gjejnë zbatim gjatë kësaj faze të shqyrtimit të çështjes. Në rastin konkret, nuk rezulton që Gjykata e Lartë të ketë vënë në diskutim çështje të ligjit, për sa i përket zbatimit të ligjit në rastin e kërkuarit, për të cilat palët nuk kanë qenë në dijeni ose nuk kanë pasur mundësinë të debatonin ose të jepnin mendimin e tyre më parë. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen e kërkuarit dhe ka vendosur sipas një procedure të përcaktuar ligjërisht, ndaj e drejta kushtetuese për t'u dëgjuar nuk vihet në dyshim. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit është haptazi i pabazuar.

15. Për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, kërkuari ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrim të ndryshëm në një vendim me të njëjtin objekt, në të cilin ai ka pranuar kompensimin e palës paditëse për orët e punës shtesë. Gjykata ka mbajtur qëndrimin se, kur kërkuarit kanë pretenduar cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit në lidhje me mënyrën sesi gjykatat kanë vendosur në raste të ngjashme, atëherë vlerësimi kushtetues i mënyrës së zgjidhjes së çështjeve të ngjashme nga gjykatat e zakonshme bëhet duke verifikuar rrethanat e rastit konkret. Fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të justifikojë *apriori* pretendimet e individit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në vështrim të këtyre standardeve, Kolegji evidenton se Gjykata e Lartë në vendimmarrjen e saj nuk rezulton të ketë vendosur në mënyrë të ndryshme me ndonjë vendim

unifikues ose njësues të praktikës gjyqësore. Në këtë kuptim, fakti që Kolegji Administrativ i asaj gjykate mund të ketë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, nuk përbën argument që mund të mbështesë pretendimin për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor nga pikëpamja kushtetuese, për rrjedhojë edhe ky pretendim i kërkuarit është haptazi i pabazuar.

17. Ndërsa për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për një gjykim të drejtë e të paanshëm, ai, në thelb, ka të bëjë me mënyrën sesi gjykatat e zakonshme kanë zbatuar dispozitat ligjore, për rrjedhojë ai do të analizohet në këndvështrim të standardit të arsyetimit të vendimit, i cili *prima facie* bën pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit

18. Kërkuari ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka arsyetuar se përse ai nuk ka paraqitur shkaqe në rekurs që lidhen me zbatimin e gabuar të ligjit material, ndonëse këto shkaqe lidhen me interpretimin e gabuar të Kodit të Punës, Kodit Doganor dhe disa VKM-ve për kohëzgjatjen e punës dhe pushimit në institucionet shtetërore. Kërkuari ka pretenduar se është paguar vetëm për orarin zyrtar, ndonëse ekspertimi ka përcaktuar se ai ka kryer 174 orë punë në muaj edhe në ditët e pushimit javor, festave zyrtare dhe orëve jashtë orarit. Në kushtet kur kërkuari nuk është më në marrëdhënie pune ai nuk ka mundësi të kompensohet për këto orë pune. Sipas kërkuarit, gjykata e apelit në mënyrë të gabuar ka përcaktuar se kërkuari është trajtuar me dietë, arsyetim i cili është në kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi për punonjësit doganorë nuk përfshihen shpenzimet e transportit, por vetëm ato për fjetje dhe ushqim. Për më tepër, sipas tij, natyra e punës së punonjësve të Antikontrabandës është e vështirë dhe ligji ka parashikuar që ata përfitojnë pagesë për punën në ditët e pushimit javor dhe festat zyrtare. Pala e paditur nuk ka provuar në gjykim se ka miratuar turne shtesë për të kompensuar me pushim këto orë pune, si dhe ligji nuk ka përcaktuar se për shkak të vështirësisë së punës punëmarrësi duhet të punojë jashtë orarit dhe në ditët e pushimit javor e festat zyrtare.

19. Gjykata është shprehur se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë*

16.02.2021; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata ka pohuar se vendimet e Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata ka pohuar se problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Mënyra sesi gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese, me përjashtim të rastit kur kjo mënyrë veprimi e gjykatës së zakonshme provohet se ka cenuar të drejta kushtetuese të individit që vë në lëvizje këtë Gjykatë, në kuptimin që procesi në tërësinë e tij rezulton haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar (*shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji vëren se padia e kërkuarit është pranuar pjesërisht nga gjykata e shkallës së parë me arsyetimin se referuar VKM-së nr. 205, datë 13.04.1999 “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor”, të ndryshuar, dhe provave shkresore, kërkuari ka kryer punë përgjatë ditëve të pushimit javor dhe festave zyrtare, si dhe orë pune shtesë tej orarit zyrtar dhe në kushtet kur nuk është provuar se është paguar për këto orë pune shtesë kërkimi është i bazuar. Bazuar në të dhënat e ekspertit, kjo gjykatë ka vlerësuar shumën që detyrohet pala e paditur për orët e punës shtesë jashtë orarit zyrtar.

22. Mbi ankimin e palës së paditur, gjykata e apelit ka arritur në përfundime të ndryshme me gjykatën e shkallës së parë. Sipas gjykatës së apelit, marrëdhënia e punës rregullohet mbi bazën e parashikimeve të Kodit të Punës, Kodit Doganor, VKM-së nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe akteve të tjera nënligjore të dala në zbatim të tyre. Sipas asaj gjykate, kërkuari mund të kërkojë të drejtën e pretenduar brenda një afati trevjeçar nga dita e lindjes të së drejtës (që i korrespondon datës 25.07.2011, deri në ditën e largimit të tij nga puna, datë 24.12.2013), bazuar në nenin 203 të Kodit të Punës. Ndërsa për sa i përket thelbit të kërtimeve, kjo gjykatë ka pohuar se kërkuari ka punuar edhe në ditët e pushimit javor edhe në ditët e festave zyrtare, si dhe për ditët që ka punuar në largësi mbi 100 km larg qendrës së punës, ai është trajtuar edhe me dietat përkatëse. Në zbatim të VKM-

së nr. 511, datë 24.10.2002, të ndryshuar me VKM-në nr. 463, datë 16.06.2011, si dhe udhëzimit të ministrit të Financave të nxjerrë në zbatim të saj, punonjësve të institucioneve shtetërore, për orët e punuara tej kohës normale të punës u lind e drejta të kompensohen me pushim në masën e parashikuar në këto dispozita, por parashikimet në fjalë ndalojnë kompensimin financiar të orëve shtesë mbi kohën normale të punës. Kompensimi financiar me shtesë mbi pagë parashikohet si përjashtim nga dispozitat e mësipërme vetëm për punonjësit që kryejnë veprimtari të drejtpërdrejtë operacionale dhe në rastet e pamundësisë së kompensimit me pushim për shkak të veprimtarisë operacionale, ndërsa në rastin e kërkuarit veprimtaria që ai kryente nuk është e tillë, madje as nuk është pretenduar nga ai. Ndonëse kërkuari i referohet VKM-së nr. 511/2002, ajo ka ndryshuar me VKM-në nr. 463/2011, për rrjedhojë ndaj tij nuk aplikohet përjashtimi për pagimin e orëve shtesë.

23. Për rekursin e kërkuarit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012. Ky kolegji ka vlerësuar se në rekursin e paraqitur nga kërkuari nuk është parashtruar asnjë argument i qenësishëm që të lidhet me një nga shkaqet e këtij neni, për të cilat mund të ushtrohet e drejta e rekursit dhe se nuk është rasti as për të vënë në diskutim ndonjë çështje ligjore që mund të shqyrtohet kryesisht nga gjykata.

24. Nga sa më lart, referuar vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, Kolegji çmon se ato përmbushin elementet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për standardin e arsyetimit të vendimit. Gjykata e apelit ka rrëzuar padinë e kërkuarit, duke arsyetuar vendimin e saj për faktet dhe ligjin e zbatueshëm, ndërsa Gjykata e Lartë, pavarësisht se me arsyetim të kufizuar, ka evidentuar shkaqet e ngritura në rekursin e kërkuarit, sikundër edhe vlerësimin e saj, për sa u përket kriterëve të pranueshmërisë së tij për shqyrtim. Vendimet nuk rezultojnë të jenë alogjike, kontradiktore ose të paqarta në përmbajtjen dhe vlerësimin e tyre. Për sa kohë nga kërkuari nuk argumentohet se zbatimi i ligjit nga gjykatat e zakonshme ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës, vetëm fakti se në përfundim të procesit gjyqësor, në të cilin palët kanë pasur mundësinë të ushtrojnë garancitë e tyre procedurale, gjykatat kanë dhënë një vendim jo në favor të tij, nuk është i mjaftueshëm për të provuar cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuarit është haptazi i pabazuar.

25. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.